

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2021 në drejtim të:

Kontributit të dhënë në procesin integruar të vendit tonë, si drejtues i kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, si dhe progresit të shënuar për sa i takon nivelit të përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator me *acquis* e BE-së, vlerësuar edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian, ku përmendim së fundmi edhe projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, miratimi i të cilit do të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e tregut dhe nxitjen e kursimeve për pension.

Implementimit të ligjeve të reja të tregut të kapitalit dhe SIK nëpërmjet plotësimit dhe përafrimit të një pjese të konsiderueshme të kuadrit ligjor dhe rregullator të këtyre tregjeve, nëpërmjet të cilave janë shtuar mundësitë dhe janë diversifikuar hapësirat për zgjerimin e pranisë së kompanive ndërkombëtare.

Avancimit të mëtejshëm drejt standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve, vlerësuar edhe nga organizatat ndërkombëtare, siç është Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime, sipas së cilës standardet dhe praktikatat e AMF-së kanë rezultuar në nivel shumë të lartë përputhshmërie me Parimet Themelore në Sigurime.

Digjitalizimit dhe përmirësimit të sistemeve të raportimit, të cilat kanë çuar në përmirësimin e aksesit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e efektivitetit në proceset mbikëqyrëse nëpërmjet integritetit të plotë të shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve në portalin “e-Albania”, zhvillimit të aplikacionit të llogaritësit të dëmeve ndaj personit në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike dhe përmirësimit të sistemit të raportimit për tregun e sigurimeve me versionin më të ri, duke shtuar funksionet dhe raportet analitike, në kuadër të proceseve mbikëqyrëse.

Mbikëqyrjes efektive të tregjeve financiare jobankare, duke vijuar me realizimin e 36 inspektimeve nga 30 inspektime *onsite* të zhvilluara në vitin 2021, si dhe vijimin e monitorimit nëpërmjet inspektimeve *offsite* për të gjitha subjektet nën mbikëqyrje.

Angazhimit dhe kontributit të dhënë lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të adresuara në raportin e *Moneyval*-it, nëpërmjet realizimit të 12 inspektimeve, nga të cilat 5 inspektime janë realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe 1 inspektim në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

Forcimit të kapaciteteve administrative të institucionit nëpërmjet organizimit të një sërë trajnimesh për stafin në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, si: Banka Botërore, FMN, Këshilli i Evropës dhe institucionet vendase, si Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Parlamentare.

Marrjen e 35 vendimeve për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, nga të cilat 19 për tregun e sigurimeve, 8 për tregun e kapitalit, 3 për Byronë Shqiptare të Sigurimeve dhe 5 për tregun e fondeve të pensionit vullnetar, si dhe sigurimin e vlerës prej më shumë se 16 milionë lekësh si të ardhura nga gjobot.

Shqyrtimit dhe trajtimit nëpërmjet regjistrit *online* të një numri total prej 173 ankesash të konsumatorëve dhe investitorëve, duke ndërhyrë në zgjidhjen e 116 prej tyre. Rreth 95% e

ankesave i përkasin tregut të sigurimeve, e më së shumti sigurimit të detyrueshëm motorik rreth 80% të ankesave totale.

Zgjerimit të bashkëpunimit me autoritetet homologe dhe evropiane nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA), Komisionin Mbikëqyrës të Sektorit Financiar të Luksemburgut (CSSF), si dhe intensifikimin e kontakteve me homologët austriakë, sllovenë dhe ukrainas.

Përfitimit të asistencës së vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare, si: FMN, IOSCO dhe IOPS për zhvillimin e kapaciteteve jo vetëm të stafit të institucionit, por edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Angazhimit për edukimin financiar të rinjve në fushën e tregut të kapitaleve, duke bashkëpunuar me organizatën *German Sparkassenstiftung Albania* për zhvillim për të dytin vit radhazi të konkursit me pjesëmarrjen e skuadrave të studentëve nga fakultetet e ekonomisë.

Organizimit të dy konferencave ndërkombëtare, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për sa u takon mundësitë të zhvillimit të shpejtë dhe progresiv të tregut të kapitalit në vendin tonë.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, duke marrë në konsideratë efektet e shkaktuara nga faktorë të jashtëm e të brendshëm, si dhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

2. Të përmirësojë metodologjinë mbikëqyrëse me bazë rreziku për tregun e sigurimeve, me qëllim ndërtimin e sistemit mbikëqyrës efektiv, që mundëson adresimin në kohë të problematikave dhe parandalimin në fazë të hershme të problemeve financiare të shoqërive të sigurimit.

3. Të mbikëqyrë në vazhdimësi plotësimin e detyrimeve ligjore të ushtrimit të veprimtarisë për shoqëritë e sigurimit, përfshirë dëmet pezull dhe kriteret për plotësimin e kapitalit minimal dhe të mbulimit të provigjioneve teknike.

4. Të kontribuojë për zhvillimin e produkteve në tregun e sigurimeve, veçanërisht të produkteve vullnetare, për zgjerimin e mbulimit dhe të përfshirjes në tregun e sigurimeve.

5. Të hartojë brenda vitit 2023 dhe ta paraqesë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat metodologjinë, me synim aplikimin e faktorëve të riskut në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik, në funksion të profilizimit të primit të sigurimit, sipas segmenteve të riskut (historiku i dëmeve, fuqia motorike, mosha e të siguruarit, eksperiencia në drejtimin e mjetit motorik, burimi i energjisë së mjetit, distanca vjetore e përshkruar, qarku i regjistrimit të mjetit dhe vjetërsia e mjetit).

6. Të përmbyllë miratimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjit për tregjet financiare të bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe të parapërgatitë kuadrin rregullator në zbatim të projektligjit për fondet private të pensionit, i cili pritët të miratohet së shpejti.

7. Të bashkëpunojë me subjektet që operojnë në tregun e pensioneve private, me qëllim organizimin e fushatave sensibilizuese për njohjen e publikut me përfitimet nga ndryshimet ligjore që pritët të miratohen.

8. Të vijojë kontrollin e përmbylljes së pagesave të prapambetura të fondit të kompensimit, me qëllim frenimin në të ardhmen të akumulimit të detyrimeve dhe moskryerjen e pagesave brenda afateve të arsyeshme.

9. Të angazhohet në implementimin e teknologjive të reja, me qëllim përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike.

10. Të nxisë modernizimin e tregjeve nën mbikëqyrje për të riorientuar investimet drejt teknologjive të gjelbra, si dhe për të financuar rritjen e tregjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

11. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave për finalizimin dhe implementimin sa më parë të strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, me qëllim rritjen e pjesëmarrësve në këtë treg, zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare dhe përmirësimit të eficiencës së tregut.

12. Të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera në vend për sa u përket nismave në funksion të edukimit financiar dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, të përmirësojë sistemin e ankesave dhe të pasurojë faqen zyrtare *online* me informacione të dedikuara për publikun.

13. Të vijojë bashkëpunimin me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend, në kuadër të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave për adresimin e rekomandimeve të *Moneyval*-it.

14. Të forcojë kapacitetet mbikëqyrëse të stafit të Autoritetit, me fokus përmirësimin e aftësive për menaxhimin e skenarëve të krizave të tregjeve nën mbikëqyrje.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 20.7.2023.